



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezuar Prinjehoj / Prodato Received / Delivered	21. 10 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/STAK	6369/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.928/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.928/2022 të datës 18.10.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat me adresë rruga pa numër në Lipjan, kundër organit të punësimit/Komunës së Ferizajt, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 21.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.928/2022 të datës 18.10.2022 të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi përmes përfaqësuesit të tij, fizikisht më datë 18.10.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 6274/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të vërtetimit jo të drejtë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, lidhur me mos pranimin në pozitën Drejtor në Shkollën e Mesme të Ulët "Tefik Çanga" në Komunën e Ferizajt.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 6274/2022 e datës 18.10.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 03.10.2022; Vendimin për refuzimin e ankesës me Nr. 07 Nr./365 i datës 19.09.2022 nga Komisioni i Ankesave i Komunës

së Ferizajt; Ankesën e ankuesit e datës 30.08.2022 e parashtruar në Komisionin për Ankesa dhe Parashtrësia; Diplomën me Nr. 217 të datës 01.10.2019 për ankuesin; Certifikatën me Nr.9482/003 shtator 2020 për trajnim Udhëheqja dhe planifikimin strategjik në Arsimin Parauniversitar“; Licencën e Mësimdhënësit me Nr. 100006386 e datës 10.12.2012; Letërnjoftimin për ankuesin.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të provave të lëndës, ka konstatuar që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, *SEPSE*:

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që nuk është pranuar në pozitën Drejtor në Shkollën e Mesme të Ulët “Tefik Çanga” në Komunën e Ferizajt, dhe për këtë më datë 30.08.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa dhe Parashtrësia për stafin arsimor të Komunës së Ferizajt, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit me Nr.07 Nr./365 të datës 19.09.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e udhëzuar që pala e pakënaqur me këtë vendim mund të hapë Konflikt Administrativ pranë Gjykatës Administrative në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kolegji i Këshillit, lidhur me vendosjen e kësaj çështje administrative ka konstatuar se Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht neni 2 paragrafi 2 ka kategorizuar zyrtarët publikë në: 2.1 nëpunësi i shërbimit civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i shërbimit publik; 2.3. nëpunësi i kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës, ndërsa sipas paragrafit 4 të nenit 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcaktohet se: *“Nëpunësi i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtëpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore rezulton së të gjithë të punësuar duke përfshirë zyrtarët e nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Parauniversitare Arsimore të Kosovës kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publikë, kështu që pozita Drejtor në Shkollën e Mesme të Ulët “Tefik Çanga” në të cilën ankuesi ka aplikuar nuk hyn në kategorinë e nëpunësve të shërbimit civil.*

Ndërlidhur me kategorinë e nëpunësve të shërbimit publik pjesa V e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht neni 64 paragrafi 1, ka përcaktuar se: *“Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të Ligjit, marrëdhënia e punësimit për nëpunësin e Shërbimit Publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit të Punës”,* ndërsa neni 67 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcakton se: *“Themelimi i marrëdhënies së punës për një nëpunës të Shërbimit Publik bëhet vetëm në bazë të një konkursi publik dhe të hapur, të organizuar sipas këtij ligji”.*

Në kuptim të kësaj si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 24 paragrafi 4, neni 74 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nëpunësi i shërbimit publik ka të drejtë të ankohet tek punëdhënësi pastaj mund të filloj kontestin administrativ në gjykatën kompetente, rrjedhimisht lidhur me mjetet juridike ka vendosur Komisioni i Ankesave në Komunën e Ferizajt përmes Vendimit me Nr. 07 Nr./365 të datës 19.09.2022.



Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civilë si dhe duke marr parasysh faktin se pozita ku ka aplikuar ankuesi ka statusin e nëpunësit të shërbimit publik, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.928/2022 e datës 18.10.2022 të parashtruar nga ankuesi.

Siç u tha më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS **Lënda me numër A.nr.928/2022**

Avdyll BEKTESHI

Avdyll Bekteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Ferizajt;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Ferizajt;
- Arkivit të KPMSHCK-së